

**Bashkëpunimi i komunitetit serb nga komunat
veriore të vendit në adresimin e sjelljeve jo
profesionale policore dhe roli i Inspektoratit
Policor të Kosovës në përmirësimin e shërbimeve
policore**

Prishtinë, 7 mars 2024

Konteksti

Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) funksionon që nga viti 2006, kur edhe është themeluar si një agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), për të mbikëqyrur punën policore, është përkujdesur në përmbushje të përgjegjësive që rrjedhin nga Ligji Nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës. Bazuar në këtë Ligj, IPK ka mision që *përmes ushtrimit të veprimtarisë së tij, të sigurojë një shërbim policor të përgjegjshëm, demokratik dhe transparent, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara.*

Fushë veprimtaria e IPK-së është mjaft e gjerë dhe mes tjerash përfshinë:

- (a) parandalimin, zbulimin, dokumentimin dhe hetimin e veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës,
- (b) inspektimin e strukturave dhe funksioneve policore, për të siguruar llogaridhënie, efektivitet dhe efikasitet në zbatueshmërinë e ligjeve, akteve nënligjore dhe procedurave standarde të operimit;
- (c) hetimin dhe/ose inspektimin e incidenteve disiplinore të profilit të lartë, ku përfshihen të gjithë punonjësit e Policisë së Kosovës.¹
- (d) pranimin e të gjitha ankesave të qytetarëve, si dhe shqyrtimin dhe përcaktimin se cilat nga to hetohen nga IPK dhe cilat do t'i referohen Policisë së Kosovës apo organeve përgjegjëse.

Bazuar në këto përgjegjësi dhe mundësi ligjore vërehet se nuk kursehet askush nga forca e ligjit, kur ka informacion se nga radhët policore abuzohet me detyrën. Ligji në fuqi ndihmon në forcimin dhe zhvillimin e Policisë, mbron liritë dhe të drejtat e qytetarëve, si dhe adreson shqetësimet e tyre në rastet kur dyshohet se nga radhët policore shkelen rregullat e punës dhe sjelljes.

IPK gjatë punës së përditshme trajton me prioritet shqetësimet nga qytetarët e komuniteteve pakicë dhe grupet e marginalizuara brenda shoqërisë dhe gjithë ky përkushtim është rezultat i udhëheqjes nga parimet e profesionalizmit, objektivitetit, paanshmërisë politike dhe mos-diskriminimit. IPK reflekton përbërjen multi-etnike të Republikës së Kosovës së bashku me parimet e barazisë gjinore dhe të drejtat e njeriut të garantuara më Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Si rezultat i ngritjes së besueshmërisë dhe transparencës në raport me publikun, IPK bashkëpunon me të gjitha komunitetet, duke i mbështetur ato në respektimin e të drejtave dhe lirive të tyre, drejt krijimit të një policie sa më profesionale dhe me integritet, që mund t'i kontribuojë zhvillimit të një ambienti sa më të sigurt.

¹ Incident disiplinor i profilit të lartë nënkupton incidentin ose trendin e ngjarjeve që tërheqin vëmendje domethënëse të publikut duke përfshirë mes tjerash edhe konfliktet apo incidentet e drejtpërdrejta në mes policisë dhe komuniteteve që ndërlihet me veprimet racore, etnike apo diskriminuese.

Trajtimi i ankesave të qytetarëve

IPK ka të strukturuar në kuadër të organizimit të saj të brendshëm, një departament, i cili në mënyrë të veçantë trajton çdo ankesë të drejtuar nga qytetarët, lidhur me shkelje të supozuara të pjesëtarëve të Policisë. Departamenti i Menaxhimit të Ankesave (DMA) të IPK-së gjatë vitit 2023 ka pranuar 1.697 ankesa (informata) të natyrave të ndryshme, nga qytetarë të përkatësive të ndryshme etnike.

Nr.	Etniciteti	2019	%	2020	%	2021	%	2022	%	2023	%
1	Shqiptar	1.149	79.8	1.379	83.2	1.748	86.8	1.481	87.3	1.504	88.6
2	Serb	74	5.1	51	3.1	74	3.7	71	4.2	52	3.1
3	Turq	2	0.1	0	0.0	0	0.0	0	/	0	/
4	Boshnjak	13	1.0	4	0.2	10	0.5	8	0.5	6	0.4
5	RAE	2	0.1	0	0.0	0	0.0	0	/	0	/
6	Të huaj	5	0.4	3	0.2	4	0.2	2	0.1	2	0.1
7	I panjohur	194	13.5	221	13.3	177	8.8	135	8	133	7.8
	Gjithsej	1.439	100	1.658	100	2.013	100	1.697	100	1.697	100

Nga tabela nr. 1 që është gjeneruar nga raportet vjetore të IPK-së për periudhën pesë vjeçare (2019-2023) vërehet se IPK gëzon besueshmëri tek të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë. Numri i ankuesve serb që adresojnë shqetësimet e tyre në IPK për pesë vitet e fundit sillet nga 3.1% deri në 5.1% të numrit të përgjithshëm të ankuesve. Nëse vështrojmë raportin e tillë me atë demografik, pasqyrohet se është në proporcion edhe me raportin ndërmjet numrit të banorëve serb me numrin e përgjithshëm të banorëve në Kosovë, që sillet rreth 3.4% (shih tabelën 2).

Numri	2019	2020	2021	2022	2023
Pjesëmarrja e ankesave të komunitetit serb (%)	5.1	3.1	3.7	4.2	3.1
Pjesëmarrja e serbëve në numrin e përgjithshëm të popullsisë së Kosovës ²	3.4	3.4	3.4	3.4	3.4

DMA brenda përgjegjësive të përcaktuara ka shqyrtuar ankesat dhe informatat e pranuar dhe ka kualifikuar varësisht shkeljeve të supozuara. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen të dhënat mbi numrin e ankesave dhe informatave të pranuar nga banorët e komunave të pjesës veriore të Republikës së Kosovës për pesë (5) vitet e fundit. Pas pranimit dhe analizimit të ankesave, të njëjtat janë dërguar në organet kompetente për hetim, varësisht prej kualifikimit se a kanë elemente penale apo elemente të shkeljeve disiplinore (shih tabelën 3).

Numri/Viti		2019	2020	2021	2022	2023
Numri i ankesave dhe informatave		55	80	58	59	40
Kualifikimi	Me elemente të veprës penale	31	43	24	42	13
	Me elemente disiplinore	24	37	34	17	27

² Llogaritjet janë marrë nga Regjistrimi i Popullsisë i viti 2011, që përfshinë dhe vlerësimin e pjesës veriore të Kosovës. Sipas Vjetarit Statistikor të Republikës së Kosovës (2023), Republika e Kosovës në Regjistrimin e vitit 2011 ka pasur 1.780.021. Në vitet pasuese ka pasur vetëm vlerësime, meqë nuk ka pasur regjistrim të numrit të banorëve.



Natyra më e shpeshtë e ankesave për pesë (5) vitet e fundit sipas kualifikimit nga DMA përfshinë: *keqpërdorimin e pozitës apo autoritetit zyrtar, keqtrajtimin gjatë ushtrimit të detyrës, lëndimin trupor, manipulimin me prova, sjelljen e rëndë diskredituese, shkeljen e rëndë të autorizimit.*

Hetimet penale

Ankesat që kualifikohen se kanë elemente të veprës penale trajtohen nga Departamenti i Hetimeve të IPK-së (DH), që po ashtu është një pjesë strukturore e organizimit të brendshëm të agjencisë.

Viti 2019


DH të IPK-së ka trajtuar 31 raste, ku janë hetuar gjithsej 68 punonjës policor, nga të cilët, 51 me përkatësi serbe, 9 me përkatësi shqiptare, 5 me përkatësi boshnjake dhe 3 punonjës tjerë të pa identifikuar (NN). Këto raste janë adresuar nga gjithsej 39 ankues, prej të cilëve, 26 janë serbë, 1 është shqiptar, 2 janë boshnjak dhe 10 të tjera nga Policia e Kosovës, IPK, si dhe Prokurori i Shtetit sipas detyrës zyrtare.




Nga 31 raste të trajtuar, prej tyre në Prokurorinë e Shtetit janë parashtruar 8 raste me kallëzim penal, 4 me raport të veçantë dhe në Drejtorinë për Hetime të Brendshme të Policisë e Kosovës (DHB) janë proceduar 19 raste, pas trajtimit të tyre në hetim paraprak në mungesë elementesh të veprës penale, apo dyshimit të arsyeshëm.


Viti 2020

DH të IPK-së ka trajtuar 43 raste, ku janë hetuar gjithsej 71 punonjës policor, nga të cilët, 57 me përkatësi serbe, 5 me përkatësi shqiptare, 4 me përkatësi boshnjake dhe 5 punonjës tjerë të pa identifikuar (NN). Këto raste janë adresuar nga gjithsej 45 ankues, prej të cilëve, 22 janë serbë, 1 është shqiptar, 2 janë boshnjak dhe 20 të tjera nga Policia e Kosovës, IPK, si dhe Prokurori i Shtetit sipas detyrës zyrtare.






DH të IPK-së ka trajtuar 24 raste, ku janë hetuar gjithsej 27 punonjës policor, nga të cilët, 19 me përkatësi serbe, 2 me përkatësi shqiptare, 1 me përkatësi boshnjake dhe 5 punonjës tjerë të pa identifikuar (NN). Rastet janë adresuar nga 27 ankues, prej të cilëve, 18 janë serbë, 2 janë shqiptarë, 1 është ashkali dhe 6 të tjera nga Policia e Kosovës dhe IPK sipas detyrës zyrtare.



Nga 43 raste të trajtuar, prej tyre në Prokurori të Shtetit janë parashtruar 9 raste me kallëzim penal, 4 raste me raport të veçantë dhe 1 rast me raport informues, të cilat kanë qenë nën hetim penal dhe paraprak.^[1] Në DHB janë proceduar 27 raste. Pas zhvillimit të hetimeve paraprake, 2 raste janë mbyllur në Arkivin e IPK-së.

Viti 2021




Nga 24 raste të trajtuar, prej tyre në Prokurorinë e Shtetit janë parashtruar 4 raste me kallëzim penal, 1 me raport të veçantë dhe 2 me raport informues, të cilat kanë qenë nën hetim penal dhe paraprak. Në DHB janë proceduar 13 raste, pas trajtimit të tyre në hetim paraprak në mungesë elementesh të veprës penale apo dyshimit të arsyeshëm. Pas zhvillimit të hetimeve paraprake, 3 raste janë mbyllur në Arkivin e IPK-së, ndërsa 1 rast është në proces.

[1] Raportet informuese parashtrohen edhe në fazën e hetimit paraprak me numër të DMA-së, për udhëzime të mëtutjeshme nga Prokurori i Shtetit.



Viti 2022

DH të IPK-së ka trajtuar 42 raste, ku janë hetuar gjithsej 68 punonjës policor, nga të cilët, 53 me përkatësi serbe, 8 me përkatësi shqiptare, 1 me përkatësi boshnjake dhe 6 punonjës tjerë të pa identifikuar (NN). Rastet janë adresuar nga 42 ankues, prej të cilëve, 20 janë serb, 5 janë shqiptar, 1 është boshnjak dhe 16 të tjera nga Policia e Kosovës dhe IPK sipas detyrës zyrtare.




Viti 2023

DH të IPK-së ka trajtuar 13 raste, ku janë hetuar gjithsej 18 punonjës policor, nga të cilët, 2 me përkatësi serbe, 13 me përkatësi shqiptare dhe 3 punonjës tjerë të pa identifikuar (NN). Rastet janë adresuar nga 23 ankues, prej të cilëve, 17 janë serb, 1 është shqiptar, 5 të tjera nga Policia e Kosovës dhe IPK sipas detyrës zyrtare.



Nga 42 raste të trajtuar, prej tyre në Prokurorinë e Shtetit janë parashtruar 12 raste me kallëzim penal, 2 me raport të veçantë dhe 7 me raport informues, të cilat kanë qenë nën hetim penal dhe paraprak. Në DHB janë proceduar 20 raste, pas trajtimit të tyre në hetim paraprak në mungesë të elementeve të veprës penale apo dyshimit të arsyeshëm. Pas zhvillimit të hetimeve paraprake, 1 rast është mbyllur në Arkivin e IPK-së.



Nga 13 raste të trajtuar, prej tyre në Prokurorinë e Shtetit janë parashtruar 2 raste me kallëzim penal, 3 me raport të veçantë dhe 1 me raport informues, të cilat kanë qenë nën hetim penal dhe paraprak. Në DHB janë proceduar 3 raste, pas trajtimit të tyre në hetim paraprak në mungesë të elementeve të veprës penale apo dyshimit të arsyeshëm, ndërsa 4 raste janë në proces.

Inspektimi i strukturave dhe funksioneve policore

Në kuadër të IPK-së funksionon edhe Departamenti i Inspektimit me një rol të rëndësishëm në shtytjen para të Policisë për të përmirësuar shërbimin ndaj publikut. Departamenti inspekton strukturat dhe funksionet policore, për të siguruar llogaridhënie, efektivitet dhe efikasitet në zbatueshmërinë e ligjeve, akteve nënligjore dhe procedurave standarde të operimit.

Departamenti i Inspektimit brenda përgjegjësi të tij ka realizuar një varg inspektimesh në fusha të ndryshme, operative, administrative, humane, etj, për të vlerësuar kryerjen e detyrave policore. Në shumë inspektime, objekt i inspektimeve kanë qenë edhe stacionet policore në komunat veriore të vendit, nga personeli i të cilave është ofruar bashkëpunim i duhur.

Në pesë vitet e fundit, inspektimet kanë përfshirë disa fusha të menaxhimit, me një shtrirje edhe në stacionet policore që funksionojnë në kuadër të Drejtorisë Rajonale Policore - Mitrovicë Veriu, përfshirë Mitrovicë Veriu, Leposaviqin, Zveçanin dhe Zubin Potokun.

Menaxhimi i thirrjeve dhe reagimi policor, pajisjet në funksion të aktiviteteve operative dhe mbështetëse, administrimi i urdhëresave të gjykatave, menaxhimi i dhomave të dëshmive janë disa nga fushat e inspektimit që janë zhvilluar edhe në stacionet e kësaj pjese të vendit. Po ashtu, IPK ka zhvilluar edhe një projekt për të vlerësuar besueshmërinë dhe kënaqshmërinë e qytetarëve me shërbimet policore, ku një numër i konsideruar i të anketuarve kanë qenë nga këto komuna.